



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

**RREGULLORE (ZKM) NR. 03/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM
DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË E
MENAXHIMIT EMERGJENT¹**

¹ Rregullore (ZKM) Nr. 03/2026 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës për Agjencinë e Emenaxhimit Emergjent, miratuar me Vendimin Nr.343/2026, të dates: 26.01.2026.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 9, paragrafi 1.3 i Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenit 28 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Ligjit për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent dhe nenit 9 paragrafët 2 dhe 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura:

Nxjerr:

RREGULLORE (ZKM) NR. 03/2026 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent (në tekstin në vijmë Agjencia).

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë përcaktuar me Ligjin për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS NË AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT

Neni 3 Misioni i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent

Misioni i Agjencisë është mbështetja e qytetarëve dhe reaguesve të parë për të siguruar punë të përbashkët si një trup, me qëllim të zhvillimit, mbajtjes dhe avancimit të kapacitetit tonë për t'u përgatitur, mbrojtur, reaguar, dhe rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet, qofshin ato natyrore apo të shkaktuara nga faktori njeri.

Neni 4

Struktura organizative e Agjencisë

1. Struktura organizative e Agjencisë është si vijon:
 - 1.1 Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;
 - 1.2 Departamentet;
 - 1.3 Divizionet.
2. Numri i të punësuarve në Agjencinë Menaxhimit Emergjent është dyqind e nëntëdhjetë e shtatë (297) nëpunës.

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv përbëhet nga:
 - 1.1 Drejtori Ekzekutiv;
 - 1.2 Dy (2) Zëvendës drejtor Ekzekutiv;
 - 1.3 Dy (2) nëpunës civil të nivelit profesional.
2. Zyrtari i lartë certifikues, gjithashtu i përgjigjet drejtpërdrejt Drejtorit Ekzekutiv.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen me Ligjin në fuqi për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, me Ligjin në fuqi për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e nëpunësve civil të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publikë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
5. Numri i të punësuarve në kuadër të Zyrës së Drejtorit Ekzekutiv është gjashtë (6) nëpunës civil.

Neni 6

Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë

1. Departamentet dhe Divizionet Agjencisë, janë:
 - 1.1. Departamenti i Parandalimit me divizionet si në vijim:

- 1.1.1. Divizioni i Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë;
 - 1.1.2. Divizioni i Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë;
 - 1.1.3. Divizioni i Përpunimit të të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesimit Publik për Rreziqet nga Zjarri.
- 1.2. Departamenti i Gatishmërisë me divizionet dhe/apo njësitë në vijim:
- 1.2.1. Divizioni i Planifikimit dhe Koordinimit të Gatishmërisë Emergjente;
 - 1.2.2. Divizioni i Programeve dhe Standardeve të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit;
 - 1.2.3. Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim;
 - 1.2.4. Qendra e Ushtrimeve të Integruara.
- 1.3. Departamenti i Operacioneve me divizionet në vijim:
- 1.3.1. Divizioni i Koordinimit të Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes;
 - 1.3.2. Qendra Operative e AME-së;
 - 1.3.3. Qendrat Operative Emergjente 112 të organizuara në nivel lokal, si në vijim:
 - 1.3.3.1. Qendra Operative Emergjente 112 Prishtinë;
 - 1.3.3.2. Qendra Operative Emergjente 112 Mitrovicë;
 - 1.3.3.3. Qendra Operative Emergjente 112 Pejë;
 - 1.3.3.4. Qendra Operative Emergjente 112 Prizren;
 - 1.3.3.5. Qendra Operative Emergjente 112 Gjilan;
 - 1.3.3.6. Qendra Operative Emergjente 112 Ferizaj;
 - 1.3.3.7. Qendra Operative Emergjente 112 Mitrovicë – Veri;
 - 1.3.3.8. Qendra Operative Emergjente 112 Gjakovë.
- 1.4 Departamenti i Inspektiveve me divizionet në vijim:
- 1.4.1 Divizioni i Masave të Mbrojtjes nga Zjarri;
 - 1.4.2 Divizioni i Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

1.5 Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme me divizionet në vijim:

1.5.1 Divizioni i Logjistikës dhe Shërbimeve;

1.5.2 Divizioni i Administrimit të Dokumenteve;

1.5.3 Divizioni i Teknologjisë Informative.

1.6 Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare;

1.7 Divizioni Ligjor;

1.8 Divizioni i Burimeve Njerëzore;

1.9 Divizioni për Komunikim me Publikun;

1.10 Divizioni për Buxhet dhe Financa;

1.11 Divizioni i Prokurimit.

Neni 7 **Departamenti i Parandalimit**

1. Misioni i Departamentit të Parandalimit është vlerësimi i rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, koordinimi i ndërmarrjes së veprimeve të organizuara dhe të koordinuara për parandalimin e fatkeqësive apo zvogëlimin e pasojave të tyre, si dhe përpunimi i të dhënave për zjarre dhe vetëdijesimit publik për rreziqet nga zjarri.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Parandalimit, janë:

2.1. identifikimi, parandalimi dhe zvogëlimi i rreziqeve permanente ndaj njerëzve, të mirave materiale dhe mjedisit;

2.2. zhvillimi dhe menaxhimi i programeve të destinuara për zvogëlimin e humbjeve në shtëpi, biznese, shkolla, ndërtesa private/publike, shërbime dhe infrastrukturë jetike nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri;

2.3. identifikimi i rreziqeve, vlerësimi i rrezikshmërisë dhe hartimi i strategjive për menaxhimin e rreziqeve të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

2.4. hartimi i draft planeve për parandalimin e rrezikut;

2.5. përkrahja e subjekteve rajonale dhe lokale në grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave dhe raporteve të veçanta lidhur me ndodhjen, kontrollin dhe pasojat e çdo fatkeqësie;

- 2.6. shkëputja e ciklit të dëmeve të fatkeqësive, zhvillimit të serishëm të tyre, dhe dëmeve të përsëritura përmes vendosjes dhe zbatimit të masave parandaluese;
 - 2.7. aplikimi i teknologjisë përmes projekteve për hulumtimin, parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për zhvillimin, parandalimin, shpëtimin dhe lokalizimin e zjarreve;
 - 2.8. përpunimi analitik statistikor i të dhënave;
 - 2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në kuadër të Departamentit bëjnë pjesë divizionet në vijim:
 - 3.1. Divizioni për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë;
 - 3.2. Divizioni për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë;
 - 3.3. Divizioni për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri.
 4. Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit të Parandalimit i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.
 5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Parandalimit është njëmbëdhjetë (11) nëpunës civil.

Neni 8

Divizioni për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë

1. Misioni i Divizionit të Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë është të identifikojë, analizojë dhe vlerësojë ndikimet e mundshme të rreziqeve natyrore dhe kërcënimeve të tjera, duke informuar strategjitë për uljen e cenueshmërisë dhe zhvillimin e aftësisë ripërtëritëse.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë, janë:
 - 2.1. grumbullimi, identifikimi, analizimi dhe vlerësimi i të dhënave për rreziqet e mundshme që rrezikojnë jetën, të mirat materiale dhe mjedisin;
 - 2.2. zhvillimit të projekteve dhe programeve për identifikimin, vlerësimin e rreziqeve;
 - 2.3. koordinimi i aktiviteteve për vlerësimin dhe hartëzimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - 2.4. hartimi i udhëzuesve profesionale, standardeve dhe normave teknike në harmoni me ligjet e aplikueshme dhe rregullat evropiane nga fusha e identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve;

2.5. koordinimi i aktiviteteve të divizionit me institucione dhe palë përkatëse të interesit në nivelit qendror dhe lokal për grumbullimin, identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e të dhënave për rreziqet;

2.6. shqyrtimi i draft-dokumentit të Vlerësimit të Rrezikut në nivel lokal, si dhe bartësve të tjerë me shërbime në më shumë se një komunë dhe jep opinion profesional dhe përmbajtësor për miratim tek organi kompetent;

2.7. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë raporton tek Drejtori i Departamentit të Parandalimit.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Vlerësimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë është tre (3) nëpunës civil.

Neni 9

Divizioni për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Fatkeqësitë

1. Misioni i Divizionit të Zvogëlimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë është të zvogëlojë ndikimet negative të fatkeqësive në jetën e njerëzve, prona dhe mjedis duke i parandaluar rreziqet e reja, duke i zvogëluar rreziqet ekzistuese dhe duke i menaxhuar rreziqet e mbetura.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë, janë:

2.1 hartimi i programeve edukuese me qëllim të ngritjes së vetëdijes së komunitetit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë;

2.2 asistimi në harmonizimin, mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për humbjet, dëmet dhe cenueshmërinë e komuniteteve në fushën e zvogëlimit të rrezikut nga FNFTF;

2.3 përgatitja e plan-programit, organizimi dhe vlerësimi i kandidatëve për dhënien e provimit profesional në lëmin e mbrojtjes nga zjarri dhe punë me materiale të rrezikshme;

2.4 hulumtimi dhe zhvillimi i projekteve dhe teknologjisë për zbulimin dhe lokalizimin e shkaqeve të rrezikut nga FNFTF;

2.5 avancimi, zhvillimi dhe aplikimi i teknologjisë përmes projekteve për hulumtimin, parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.6 përpilimi i raporteve përmbajtësore për aktivitetet e kryera në fushën e Zvogëlimit të Rreziqeve nga FNFTF dhe mbajtja e evidencave përkatëse;

2.7 kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë raporton tek Drejtori i Departamentit të Parandalimit.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë është katër (4) nëpunës civil.

Neni 10

Divizioni për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri

1. Misioni i Divizionit për Përpunimin e të Dhënave nga Zjarri dhe Ndërgjegjësimin Publik për Rreziqet nga Zjarri është të zvogëlojë incidentet, lëndimet dhe dëmet e pronës që lidhen me zjarrin përmes strategjive të bazuara në të dhëna dhe edukim publik.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri, janë:
 - 2.1. kryerja e punëve analitike lidhur me operacionet apo intervenimet e zjarrëfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.2. grumbullimi, përpunimi dhe azhurnimi i të dhënave në lidhje me punimin e bazës hartografike për udhëheqje të suksesshme të intervenimeve të zjarrëfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.3. përgatitja e broshurave dhe materialeve tjera profesionale dhe paraqitja e tyre në revista profesionale dhe faqe zyrtare të AME-së;
 - 2.4. përpunimi analitik statistikor i të dhënave;
 - 2.5. shpërndarja koherente e të dhënave për operacionet e reagimit tek strukturat përkatëse;
 - 2.6. përgatitja e pasqyrave grafike ku pasqyrohen, numri dhe lloji i operacioneve, njësitë e angazhuara, pasojat dhe rezultatet e operacioneve;
 - 2.7. zhvillimi dhe implementimi i programeve të ngritjes së vetëdijes për rrezikun nga zjarri, edukimit publik, ndërtimi i partneriteteve me sektorët publik dhe privat dhe përqendrimi i veçantë për grupet në rrezik;
 - 2.8. organizimi i kampanjave publike lidhur me rëndësinë e vetëdijesimit për rreziqet nga zjarri dhe ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtje personale dhe kolektive; dhe
 - 2.9. përgatitja dhe dhënia e informacioneve të rëndësishme lidhur me rreziqet që paraqesin zjarret për komunitetin;
 - 2.10. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri raporton tek Drejtori i Departamentit të Parandalimit.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri është tre (3) nëpunës civil.

Neni 11

Departamenti i Gatishmërisë

1. Misioni i Departamentit të Gatishmërisë është përfshirja e integruar e vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve, ushtrimeve, kualifikimit dhe certifikimit të personelit dhe pajisjeve.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Gatishmërisë, janë:
 - 2.1. udhëheqja e iniciativave të veçanta, drejtimi i përpjekjeve të politikave të planifikimit për gatishmëri emergjente;
 - 2.2. rishikimi i rezultateve të politikave të gatishmërisë së përgjithshme emergjente;
 - 2.3. zhvillimi dhe zbatimi i programit të gatishmërisë së përgjithshme ndaj rreziqeve të të gjitha llojeve;
 - 2.4. zhvillimi dhe fuqizimi i kapacitetit të institucioneve të nivelit qendror, lokal dhe sektorit privat në lëmin e parandalimit, mbrojtjes, reagimit dhe rimëkëmbjes nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri;
 - 2.5. hartimi i draft - planeve të gatishmërisë dhe reagimit kombëtar;
 - 2.6. hartimi i draft - planeve për mbrojtjen e infrastrukturës dhe resurseve jetike;
 - 2.7. hartimi i draft-planeve të vijimësisë së qeverisjes në koordinim me institucionet përkatëse;
 - 2.8. vendosja e programeve dhe standardeve të zjarrëfikjes dhe shpëtimit në shkallë vendi;
 - 2.9. përkrahja e zhvillimit profesional, kapacitetit operativ dhe ushtrimeve për gatishmëri për komunitetin e zjarrëfikjes dhe reagimit emergjent të strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
 - 2.10. zhvillimi, menaxhimi dhe koordinimi i të gjitha programeve për ushtrime dhe ngritje të kapaciteteve në fushën e menaxhimit të emergjencave;
 - 2.11. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:
 - 3.1. Divizioni për Planifikim dhe Koordinim të Gatishmërisë Emergjente;
 - 3.2. Divizioni për Programe dhe Standarde të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit;
 - 3.3. Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim;
 - 3.4. Qendra e Ushtrimeve të Integruara.

4. Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Gatishmërisë është tridhjetë e dy (32) nëpunës civil.

Neni 12

Divizioni për Planifikim dhe Koordinim të Gatishmërisë Emergjente

1. Misioni i Divizionit të Planifikimit dhe Koordinimit të Gatishmërisë Emergjente është të sigurojë që komunitetet janë të gatshme për të parandaluar, mbrojtur, zbutur, reaguar dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë dhe emergjencat, duke zhvilluar dhe koordinuar plane dhe aftësi gjithëpërfshirëse të menaxhimit të emergjencave.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Planifikimit dhe Koordinimit të Gatishmërisë Emergjente, janë:

2.1. zbatimi i programeve të AME-së nga aspekti i analizave dhe planifikimit për gatishmëri emergjente;

2.2. rekomandimi dhe këshillimi në përcaktimin e kaheve të zhvillimit, bazuar në rezultatet e dala nga analizat për gatishmëri emergjente;

2.3. koordinimi i aktiviteteve për hartimin e draft-planeve të vijimësisë së qeverisjes në bashkëpunim me institucionet përkatëse;

2.4. dhënia e kontributit në hartimin e planeve operative emergjente të nivelit qendror dhe lokal;

2.5. pjesëmarrja aktive në planifikimin, përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e ushtrimeve me karakter sektorial, lokal dhe qendror, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe standardeve për vlerësimin e tyre;

2.6. koordinimi dhe mbështetja e politikave zhvillimore të gatishmërisë emergjente në të dy nivelet e qeverisjes;

2.7. koordinimi i aktiviteteve të juridiksioneve dhe të strukturave tjera për ngritjen e nivelit të gatishmërisë emergjente;

2.8. mbështetja dhe asistimi i ngritjes dhe fuqizimit të kapaciteteve të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në lëmin e koordinimit dhe reagimit në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

2.9. koordinimi i implementimit të programeve, projekteve dhe planeve për avancimin e gatishmërisë emergjente në të dy nivelet e qeverisjes;

2.10. koordinimi dhe harmonizimi i programeve dhe planeve të gatishmërisë emergjente në mes të niveleve të qeverisjes, sektorit privat dhe OJQ-ve;

- 2.11. dhënia e kontributit në hartimin e planeve të ushtrimeve në nivel vendi dhe programeve për ngritjen e kapaciteteve për nivelin e AME-së, dhe
 - 2.12. vlerësimi i nevojave për përgatitjen e strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë për angazhim në reagim emergjent;
 - 2.13. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim dhe Koordinim të Gatishmërisë Emergjente raporton tek Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Planifikim dhe Koordinim të Gatishmërisë Emergjente është katër (4) nëpunës civil.

Neni 13

Divizioni për Programe dhe Standarde të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit

1. Misioni i Divizionit të Programeve dhe Standardeve të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit është të minimizojë rreziqet nga zjarri dhe të sigurojë mbrojtje të përshtatshme nga zjarri, përmes vendosjes së standardeve dhe zhvillimit të programeve përkatëse.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Programe dhe Standarde të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, janë:
 - 2.1. planifikimi i standardizimit të mjeteve teknike lidhur me përmirësimin e gjendjes së organizimit, përgatitjes operative dhe pajisjes së njësive të zjarrfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.2. hartimi dhe përpunimi i procedurave standarde operative për veprim në operacionet e të zjarrfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.3. vendosja e standardeve për furnizim me pajisje, mjete dhe teknikë profesionale të njësive të zjarrfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.4. përcjellja e zhvillimeve të reja në fushën e zhvillimit të teknologjive, metodave dhe mënyrave të reja të zjarrfikjes dhe shpëtimit;
 - 2.5. përkrahja e zhvillimit profesional, kompletimit të kapacitetit operativ dhe trajnimeve për gatishmëri për komunitetin e strukturave për zjarrfikje dhe shpëtim të strukturave të sektorit publik dhe privat;
 - 2.6. planifikimi, përgatitja dhe propozimi për organizimin e seminareve profesionale dhe takimeve me kuadrot e njësive të zjarrfikjes dhe shpëtimit, si dhe subjekteve tjera relevante;
 - 2.7. mbështetja e vlerësimit të vazhdueshëm të gjendjes së gatishmërisë dhe identifikimi i nevojave të zjarrfikjes dhe shpëtimit;

2.8. vlerësimi dhe harmonizimi i draft planeve të nevojshme për trajnim dhe aftësim të pjesëtarëve të zjarrëfikjes dhe shpëtimit; dhe

2.9. kujdesi për përcaktimin e standardeve dhe verifikimin e aftësive psiko-fizike të pjesëtarëve të zjarrëfikjes dhe shpëtimit;

2.10. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Programe dhe Standarde të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit raporton tek Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Programeve dhe Standardeve të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit është tre (3) nëpunës civil.

Neni 14 **Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim**

1. Misioni i Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim është të ofrojë trajnim dhe edukim gjithëpërfshirës për individët dhe ekipet e përfshira në operacionet e kërkim-shpëtimit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës së Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, janë:

2.1. hartimi i programeve për stërvitje dhe aftësim të strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

2.2. zbatimi i programeve për stërvitje dhe aftësim nga fusha e menaxhimit të integruar të emergjencave;

2.3. zhvillimi dhe aplikimi i metodave shkencore dhe përvojave pozitive profesionale në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.4. realizimi i programit për aftësim profesional;

2.5. koordinimi i aktiviteteve me strukturat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në lëmin e realizimit të programeve stërvitore dhe aktiviteteve të tjera; dhe

2.6. kujdesi dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve për ushtrime aftësuese në qendër;

2.7. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Qendrës për Kërkim-Shpëtim raporton tek Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë.

4. Numri i të punësuarve në Qendrën për Kërkim-Shpëtim është njëzetënjë (21) nëpunës civil.

5. Qendra e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim është ekuivalente me divizionin.

Neni 15

Qendra e Ushtrimeve të Integruara

1. Misioni i Qendrës për Ushtrime të Integruara është të përmirësojë aftësitë e gatishmërisë dhe reagimit përmes trajnimeve dhe ushtrimeve të integruara.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës për Ushtrime të Integruara, janë:
 - 2.1 trajnimi, stërvitja dhe aftësimi i strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës emergjente;
 - 2.2 hartimi i programeve për stërvitje dhe aftësim të strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
 - 2.3 zbatimi i programeve për stërvitje dhe aftësim nga fusha e menaxhimit të integruar të emergjencave;
 - 2.4 zhvillimi dhe aplikimi i metodave shkencore dhe përvojave pozitive profesionale në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;
 - 2.5 realizimi i programit për aftësim profesional;
 - 2.6 koordinimi i aktiviteteve me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në lëmin e realizimit të programeve mësimore dhe aktiviteteve të tjera; dhe
 - 2.7 kujdesi dhe mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve për trajnime dhe ushtrime aftësuese në qendër;
 - 2.8 kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Qendrës për Ushtrime të Integruara raporton tek Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë.
4. Numri i të punësuarve në Qendrën e Ushtrimeve të Integruara është tre (3) nëpunës civil.
5. Qendra për Ushtrime të Integruara është ekuivalente me divizionin.

Neni 16

Departamenti i Operacioneve

1. Misioni i Departamentit të Operacioneve është koordinimi i operacioneve të reagimit emergjent të domosdoshme për shpëtimin e jetës, mbrojtjen e të mirave materiale dhe mjedisit, gjithmonë me kohë dhe në mënyrë efektive, në komunitetet të cilat mbingarkohen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe koordinimi i operacioneve të rimëkëmbjes afatshkurtër me qëllim të rikthimit të shërbimeve kritike në zonën e prekur dhe krijimit të kushteve për rimëkëmbje afatgjate.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Operacioneve, janë:

2.1. koordinimi i aktiviteteve të programit të reagimit emergjent;

2.2. koordinimi i të gjitha operacioneve të menaxhimit dhe reagimit emergjent, planifikimit të reagimit, programeve logjistike dhe integritit të programeve qendrore dhe lokale për fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera;

2.3. koordinimi i shpërndarjes efektive dhe efikase të ndihmës së menjëhershme emergjente tek personat dhe komunitetet e goditura dhe mbingarkuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.4. ndërtimi dhe mbajtja e pasqyrës së përbashkët operative për të gjitha situatat emergjente në shkallë vendi;

2.5. bashkërendimi i operacioneve të reagimit dhe të rimëkëmbjes afatshkurtër;

2.6. grumbullimi, analizimi dhe shkëmbimi i informacioneve;

2.7. koordinimi i emergjencave dhe ngritja e bashkëveprimit me strukturat përkatëse, në nivelin më të lartë të mundshëm;

2.8. informimi i përhershëm dhe me kohë i ministrit të MPB-së nëpërmjet autoritetit të Drejtorit Ekzekutiv të AME-së;

2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:

3.1. Divizioni për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes;

3.2. Qendra Operative e Agjencisë;

3.3. Qendrat Operative Emergjente 112.

4. Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Operacioneve është tetëdhjeteshtatë (87) nëpunës civil.

Neni 17

Divizioni për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes

1. Misioni i Divizionit të Koordinimit të Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes është të zhvillojë, mbështesë dhe përmirësojë koordinimin dhe ofrimin e mbështetjes për qytetarët dhe

institucionet për të shpëtuar jetë, zvogëluar vuajtjet, mbrojtur pronën dhe për t'u rimëkëmbur nga të gjitha rreziqet.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Koordinimit të Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes, janë:

2.1 ofrimi dhe koordinimi i të gjitha operacioneve emergjente dhe planeve të veprimit gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, sipas standardeve të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave;

2.2 të siguruarit që koordinimi i menaxhimit emergjent të realizohet si pjesë integrale e Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave në Kosovë;

2.3 të kujdesurit që ekipi i reagimit emergjent të ofroj raportin e shpejtë të gjendjes dhe vlerësimin preliminar të dëmeve;

2.4 ngritja dhe mbajtja e partneritetit të fortë me institucionet qeveritare, qeveritë lokale dhe grupet jo qeveritare relevante në fushën e menaxhimit emergjent;

2.5 ndërmarrja e projekteve kërkimore brenda Sistemit të Integruar të Menaxhimit Emergjent dhe me institucionet tjera përkatëse, lidhur me çështjet e reagimit emergjent;

2.6 të kujdesurit për hartimin dhe koordinimin e Planeve të Veprimit në Incidente dhe Procedurave Standarde Operative;

2.7 hartimi i programeve unike dhe funksionale për koordinimin e operacioneve të reagimit;

2.8 kujdesi për zbatimin e planeve të gatishmërisë për reagim emergjent;

2.9 koordinimi i menaxhimit të aktiviteteve të rimëkëmbjes dhe ofrimit të ndihmës emergjente për qeveritë lokale dhe komunitetet e goditura nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.10 të siguruarit që projektet e propozuara për rimëkëmbje kanë marrë parasysh çështjet e ruajtjes së mjedisit, vlerave historike dhe atyre kulturore;

2.11 zhvillimi i programeve të ngritjes së kapaciteteve dhe ushtrimeve në lëmin e operacioneve të rimëkëmbjes;

2.12 përkujdesi për nivelin e duhur të gatishmërisë së kapaciteteve të rimëkëmbjes nëpërmjet bashkërendimit të përpjekjeve të planifikimit dhe reagimit emergjent me Departamentin e Gatishmërisë;

2.13 organizimi i ushtrimeve në fushën e mbështetjes logjistike për operacionet e reagimit dhe rimëkëmbjes afatshkurtër, në koordinim me Divizionin e Logjistikës, Furnizimit dhe Transportit; dhe

2.14. ofrimi i ndihmës në hartimin dhe harmonizimin e programeve dhe planeve të rimëkëmbjes;

2.15. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes raporton tek Drejtori i Departamentit të Operacioneve.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes është tre (3) nëpunës civil.

Neni 18

Qendra Operative e Agjencisë

1. Misioni i Qendrës Operative të Agjencisë është të shërbejë si qendër qendrore për informacion dhe koordinim, veçanërisht gjatë emergjencave ose situatave kritike.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës Operative të Agjencisë, janë:

2.1. grumbullon, përpunon dhe shpërndan informacione lidhur me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe dukuritë dhe ngjarjet tjera të rëndësishme për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në shkallë vendi;

2.2. monitoron dhe sipas nevojës grumbullon apo përpunon të dhënat lidhur me vëzhgimin e kushteve meteorologjike, hidrologjike, sizmologjike, radiologjike, ekologjike, shëndetësore, trafikut dhe kushteve tjera nëpërmjet rrjeteve dhe sistemeve të vëzhgimit, të dhënave të institucioneve dhe shërbimeve kompetente, si dhe me kërkesën e institucioneve dhe shërbimeve që menaxhojnë me këto vëzhgime;

2.3. organizon dhe mirëmban bazën e të dhënave për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe operacionet e reagimit të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

2.4. merr pjesë në mirëmbajtjen e një baze të vetme të të dhënave për forcat dhe mjetet e strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, njësi, institucioneve dhe shërbimeve tjera;

2.5. njofton autoritetet përkatëse shtetërore dhe autoritetet tjera të përfshira në inspektimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe dukuritë dhe ngjarjet tjera të rëndësishme për mbrojtje nga këto fatkeqësi sipas Planit të Reagimit Kombëtar;

2.6. njofton Qendrat përkatëse 112 për informacionet dhe vendimet e autoriteteve përkatëse shtetërore lidhur me rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe u siguron atyre qasje dhe përdorim të të dhënave të disponueshme në përputhje me ligjin;

2.7. përmes QOE 112 bën alarmimin e zonave të rrezikuara sipas Planit të Reagimit Kombëtar dhe vendimeve të personave kompetent;

2.8. aktivizon strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës sipas Planit të Reagimit Kombëtar dhe vendimeve të autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës;

2.9. koordinon mbështetjen logjistike dhe mbështetjen tjetër për strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës gjatë zhvillimit të operacioneve të reagimit;

2.10. pranon dhe përcjell mesazhe lidhur me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, kontakton autoritetet dhe shërbimet përkatëse në vend dhe jashtë vendit, si dhe organizatat ndërkombëtare sipas Planit të Reagimit Kombëtar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare;

2.11. ofron mbështetje komunikimi dhe informimi për komandantin e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe stafin e tij, si dhe shërbime të specializuara për AME-në;

2.12. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Informacionet nga paragrafi 1. dhe informacionet tjera lidhur me kërcënimin dhe ndodhjen e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera të nevojshme për reagim të koordinuar dhe me kohë të strukturave të ndryshme të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, të Policisë së Kosovës dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës, QOAME i koordinon apo i shkëmben me Qendrën Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

4. Udhëheqësi i Qendrës Operative të Agjencisë raporton tek Drejtori i Departamentit të Operacioneve, ndërsa në situata emergjente i raporton Drejtori Ekzekutiv të Agjencisë.

5. Numri i të punësuarve në Qendrën Operative të Agjencisë është tre (3) nëpunës civil.

6. Qendra Operative e Agjencisë është ekuivalente me divizionin.

Neni 19 **Qendrat Operative Emergjente 112**

1. Qendrat Operative Emergjente 112 të organizuara në tetë (8) qytete të Kosovës, si në vijim:

1.1. Qendra Operative Emergjente 112 Prishtinë;

1.2. Qendra Operative Emergjente 112 Mitrovicë;

1.3. Qendra Operative Emergjente 112 Pejë;

1.4. Qendra Operative Emergjente 112 Prizren;

1.5. Qendra Operative Emergjente 112 Gjilan;

1.6. Qendra Operative Emergjente 112 Ferizaj;

1.7. Qendra Operative Emergjente 112 Mitrovicë – Veri;

- 1.8. Qendra Operative Emergjente 112 Gjakovë.
2. Misioni i Qendrave Operative Emergjente 112 është të ofrojë reagim të unifikuar, efikas dhe efektiv ndaj të gjitha situatave emergjente, duke koordinuar dhe dërguar shërbimet e duhura të emergjencës tek ata që kanë nevojë.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrave Operative Emergjente 112, janë:
 - 3.1. shërbimi si pikë qendrore për shkëmbimin e informacioneve, koordinimin e emergjencave dhe ngritjen e koordinimit ndër-komunal në nivelin më të lartë të mundshëm me partnerët rajonal, lokal, organizatat jo qeveritare dhe sektorin privat;
 - 3.2. ushtrimi i të gjitha përgjegjësive drejtuese për koordinimin e veprimeve midis strukturave të reagimit dhe mbështetjes emergjente në QOE 112;
 - 3.3. sigurimi i mbështetjes për autoritetet lokale të menaxhimit emergjent dhe i zbatimit të veprimeve sipas prioriteteve të caktuara;
 - 3.4. sigurimi i zhvillimit të mirëfilltë të koordinimit midis strukturave pjesëmarrëse në vendngjarje dhe funksioneve brenda QOE 112;
 - 3.5. mbajtja e lidhjeve të ngushta me menaxherët emergjentë dhe zyrtarët e zgjedhur të nivelit lokal; dhe
 - 3.6. sigurimi i aplikimit të procedurave dhe parimeve për menaxhimin e rreziqeve për të gjitha aktivitetet e QOE 112; dhe
 - 3.7. mban të informuar Udhëheqësin e Departamentit të Operativës për të gjitha aktivitetet e reagimit emergjent në kuadër të juridiksionit përkatës;
 - 3.8. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
4. Udhëheqësit e Qendrave Operative Emergjente 112 raportojnë tek Drejtori i Departamentit të Operacioneve.
5. Numri i të punësuarve në Qendrat Operative Emergjente është tetëdhjetë (80).
6. Qendra Operative Emergjente 112 janë ekuivalente me divizionin.

Neni 20
Departamenti i Inspektimeve

1. Misioni i Departamentit të Inspektimeve është mbikëqyrja inspektuese në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të përcaktuara me ligj në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Inspektiveve, janë:

2.1. mbikëqyrja inspektuese e prodhimit, tregtimit, furnizimit, magazinimit dhe përdorimit të materialeve shpërthyes, ruajtjes, posedimit, tregtimit, trajtimit dhe përdorimit të lëngjeve dhe gazrave të ndezshëm, objekteve në të cilat magazinohen ose përdoren materiale të rrezikshme në procese teknologjike, me qëllim të përcaktimit të zonave të rrezikut, etj.;

2.2. mbikëqyrja dhe inspektimi për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri në objekte, pjesë të objekteve, pajisje dhe stabilimente;

2.3. mbajtja e shënimeve të përcaktuara dhe përgatitja e raporteve, informacioneve, analizave, etj.;

2.4. zbatimi i masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.5. verifikimi i gjendjes së planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

2.6. propozimi për trajnimin profesional për inspektorët;

2.7. pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare në fushën e çështjeve të inspektimit;

2.8. bashkëpunimi me organet e tjera inspektuese;

2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit të Inspektiveve i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv i Agjencisë.

4. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:

4.1. Divizioni për Masat për Mbrojtje nga Zjarri;

4.2. Divizioni për Masat për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin e Inspektiveve është dyzetetë (48) nëpunës civil.

Neni 21

Divizioni i Masave për Mbrojtje nga Zjarri

1. Misioni i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Zjarri është të sigurojë sigurinë e jetës dhe pronës, duke parandaluar dhe zbutur ndikimin e zjarreve dhe rreziqeve të tjera.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Zjarri, janë:

2.1. mbikëqyrja inspektuese e prodhimit, tregtimit, furnizimit, magazinimit dhe përdorimit të materialeve shpërthyes, ruajtjes, posedimit, tregtimit, trajtimit dhe përdorimit të lëngjeve dhe

gazrave të ndezshëm, objekteve në të cilat magazinohen ose përdoren materiale të rrezikshme në procese teknologjike, me qëllim të përcaktimit të zonave të rrezikut, etj.;

2.2. mbikëqyrja dhe inspektimi për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri në objekte, pjesë të objekteve, pajisje dhe stabilimente;

2.3. zbatimi i masave administrative dhe veprimeve gjatë shfaqjeve të fishekzjarrëve;

2.4. mbajtja e shënimeve të përcaktuara dhe përgatitja e raporteve, informacioneve, analizave, etj.;

2.5. mbledhja e të dhënave dhe informacionit për vërtetimin e fakteve dhe analizimin e situatës brenda fushës së juridiksionit të tij;

2.6. propozimi i planeve të punës – kryerja e mbikëqyrjes inspektuese për vitin aktual dhe dorëzimi i raporteve për inspektimet e kryera;

2.7. propozimi për trajnimin profesional për inspektorët;

2.8. pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare në fushën e çështjeve të inspektimit;

2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Zjarri raporton tek Drejtori i Departamentit të Inspektimeve.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Masave të Mbrojtjes nga Zjarri është tridhjetenëntë (39) nëpunës civil.

Neni 22

Divizioni i Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera

1. Misioni i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera është të garantoj sigurinë e njerëzve, pronës dhe mjedisit, duke zbutur efektet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera dhe duke i parandaluar ato.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, janë:

2.1. zbatimi i masave për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

2.2. verifikimi i gjendjes së planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;

2.3. verifikimi i zbatimit të detyrave të monitorimit, lajmërimit dhe paralajmërimit;

- 2.4. verifikimi i aftësive, pajisjeve dhe gatishmërisë e SMSHN dhe shërbimeve tjera emergjente;
 - 2.5. verifikimi i mënyrës së trajtimit të çështjeve administrative dhe teknike në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
 - 2.6. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera raporton tek Drejtori i Departamentit të Inspektimeve.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera është tetë (8) nëpunës civil.

Neni 23

Departamenti për Shërbime të Përgjithshme

1. Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme ka për mision të ofrojë mbështetje administrative dhe teknike për departamentet dhe divizionet brenda Agjencisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, janë:
 - 2.1. menaxhon dhe koordinon ofrimin e shërbimeve të përgjithshme në pajtim me legjislacionin në fuqi;
 - 2.2. menaxhon sistemin arkivor dhe punët e zyrës;
 - 2.3. siguron dhe administron ofrimin e shërbimeve të përkthimeve;
 - 2.4. siguron menaxhimin e pasurisë, përfshirë edhe stoqet; dhe
 - 2.5. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si në vijim:
 - 3.1. Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime;
 - 3.2. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve;
 - 3.3. Divizioni për Teknologji Informative.
4. Departamenti udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme i cili i raporton Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.
5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Shërbime të Përbashkëta është tetëmbëdhjetë (18) nëpunës civil.

Neni 24
Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime

1. Misioni i Divizionit të Logjistikës dhe Shërbimeve është të ofrojë funksione thelbësore mbështetëse që i mundësojnë Agjencisë të operojë në mënyrë efektive.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime, janë:
 - 2.1. siguron kushtet e punës dhe të akomodimit për stafin e AME-së;
 - 2.2. menaxhon inventarin dhe depot e AME-së;
 - 2.3. bën pranimin, kontrollimin e pasurisë, menaxhimin e stokeve dhe përgatitjen e raporteve përkatëse;
 - 2.4. përcjell lëvizjen e pasurisë dhe ofron informacione të duhura lidhur me lëvizjen e pasurisë dhe përgatit dokumentacionin për lëvizjen e pasurisë – tjetërsimit;
 - 2.5. ofron shërbime për nevojat e AME-së për inventar, mallra dhe pajisje tjera të zyrës për punë;
 - 2.6. siguron ofrimin e shërbimit të transportit dhe bën menaxhimin e veturave të AME-së dhe atyre që janë në shfrytëzim të saj;
 - 2.7. ofron ndihmë logjistike mbështetëse për organizimin e takimeve të personelit të AME-së;
 - 2.8. siguron ofrimin e shërbimeve të përkthimit në gjuhët zyrtare, nga gjuhët zyrtare në gjuhë të tjera dhe anasjelltas të dokumenteve zyrtare dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për AME-në;
 - 2.9. ofron përkthimin simultan/konsekutiv në gjuhët zyrtare, nga gjuhët zyrtare në gjuhë të tjera dhe anasjelltas për nevojat e AME-së;
 - 2.10. ofron shërbimin e lekturimit; dhe
 - 2.11. kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime raporton tek Drejtori i Departamentit.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Logjistikë dhe Shërbime është nëntë (9) nëpunës civil.

Neni 25
Divizioni për Administrimin e Dokumenteve

1. Misioni i Divizionit të Menaxhimit të Dokumenteve është të menaxhojë dhe kontrollojë në mënyrë efektive të gjitha dokumentet brenda organizatës, duke siguruar që ato të jenë të arritshme, të sigurta dhe në përputhje me rregulloret përkatëse.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Administrimin e Dokumenteve, janë:
 - 2.1. zbaton procedurat për menaxhimin dhe administrimin e dokumenteve;
 - 2.2. pranon, kontrollon, klasifikon dhe evidenton dokumentet;
 - 2.3. përpunon dhe administron teknikisht aktet dhe lëndë;
 - 2.4. dërgon aktet dhe shkresat, në procedim të mëtutjeshëm;
 - 2.5. pranon postën, hapjen dhe kontrollimin, si dhe kujdeset për dërgimin e postës, shpërndarjen e postës (shkresave) dhe lëndëve, duke përfshirë edhe postën elektronike;
 - 2.6. evidenton në librin kryesor të protokollit shkresat e pranuar hyrëse dhe dalëse;
 - 2.7. kujdeset për vënien e akteve (shkresave) dhe lëndëve në arkivin e Agjencisë;
 - 2.8. vulos shkresat dhe lëndët dhe kujdeset për mbajtjen e vulave;
 - 2.9. ruan dokumentet zyrtare sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.10. administron klasifikimin e lëndëve dhe akteve (shkresave); dhe
 - 2.11. menaxhon Arkivin e Agjencisë, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.12. kryen çdo detyrë tjetër, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve raporton tek Drejtori i Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administrimin e Dokumenteve është tre (3) nëpunës civil.

Neni 26

Divizioni për Teknologji Informative

1. Misioni i Divizionit të Teknologjisë së Informacionit është ofrimi i burimeve, shërbimeve dhe mbështetjes teknologjike të besueshme dhe të sigurta për t'i mundësuar Agjencisë arritjen e qëllimeve të saj.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Teknologji Informative, janë:
 - 2.1. udhëheqë dhe cakton objektivat e tij në pajtim me strategjinë e Agjencisë dhe ASHI-së si dhe harton planet e punës vjetore të detajuara;
 - 2.2. ofron udhëzime profesionale në përdorimin e pajisjeve të TI-së për të siguruar shërbime cilësore;

- 2.3. bën mirëmbajtjen e harduerit dhe softwer-ve të teknologjisë informative;
 - 2.4. koordinon aktivitetet në fushën e TI-së me ASHI;
 - 2.5. menaxhon dhe administron sub-domenin/llogaritë zyrtare të Agjencisë;
 - 2.6. planifikon, menaxhon, monitoron të gjitha proceset që kanë të bëjnë me TI-në në zbatimin e Qeverisjes në tërësi në Agjenci;
 - 2.7. bën menaxhimin dhe administrimin e sistemeve të GIS-it dhe telekomunikimit;
 - 2.8. në koordinim me ASHI-në administron dhe mirëmban sistemet, web aplikacionet Agjencisë;
 - 2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Teknologjisë Informative raporton tek Drejtori Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Teknologjisë Informative është pesë (5) nëpunës civil.

Neni 27

Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare

1. Misioni i Divizionit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare është të nxisë dhe menaxhojë angazhimin ndërkombëtar, duke përfshirë partneritetet strategjike, bashkëpunimet e ndërsjella dhe programet e zhvillimit në fushën e menaxhimit të emergjencave.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë:
 - 2.1. bashkëpunon me autoritetet e shteteve të huaja dhe organizatat ndërkombëtare lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e Agjencisë;
 - 2.2. përmes Departamentit Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, koordinon aktivitetet në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare;
 - 2.3. përmes Departamentit për Integrim Evropian të Ministrisë së Punëve të Brendshme, koordinon aktivitetet në lidhje me projektet e huaja dhe donatorët që janë në përkrahje të Agjencisë;
 - 2.4. mbështet identifikimin dhe vlerësimin e mundësive të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare në kuadër të fushë veprimtarisë së Agjencisë;
 - 2.5. mbështet të gjitha aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të fushë veprimtarisë së Agjencisë;

2.6. mbështet bashkëpunimin me organet ndërkombëtare dhe partnerët potencial nga sektori privat;

2.7. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Marrëdhënie Ndërkombëtare është tre (3) nëpunës civil.

Neni 28 **Divizioni Ligjor**

1. Misioni i Divizionit Ligjor është të ofrojë udhëzime ligjore, të sigurojë respektimin e ligjeve dhe të mbrojë interesat e Agjencisë, përfshirë ofrimin e këshillave ligjore, pjesëmarrjen në hartimin dhe rishikimin e legjislacionit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Çështje Ligjore, janë:

2.1. bashkëpunon me Departamentin Ligjor të Ministrisë së Punëve të Brendshme në hartimin e akteve juridike që lidhen me fushë veprimtarinë e Agjencisë;

2.2. ofron këshilla ligjore për Agjencinë në çështje që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë;

2.3. ndihmon strukturat organizative të Agjencisë në identifikimin e çështjeve që kanë nevojë për rregullim ligjor;

2.4. bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë, për përgatitjen e çështjeve që lidhen me përfaqësimin në konteste gjyqësore të ndërlidhura me Agjencinë;

2.5. ofron mbështetje ligjore në hartimin e propozim-vendimeve, propozim-marrëveshjeve, propozim-memorandumeve dhe propozim-kontratave;

2.6. kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Udhëheqësi i Divizionit Ligjor raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Çështje Ligjore është tre (3) nëpunës civil.

Neni 29 **Divizioni i Burimeve Njerëzore**

1. Misioni i Divizionit për Burime Njerëzore është menaxhimi i proceseve për burimet njerëzore në mënyrë efikase, përfshirë rekrutimin, ngritjen e kapaciteteve, vlerësimin e performancës dhe kompensimin për t'u siguruar që të punësuarit mund të kontribuojnë në mënyrë efektive.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, janë:
 - 2.1. ofron mbështetje për nëpunësin më të lartë administrativ të institucionit në fushën e burimeve njerëzore;
 - 2.2. përgatit planin vjetor të personelit, në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;
 - 2.3. ofron ndihmë për njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimeve, klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës;
 - 2.4. identifikon dhe vlerëson, në koordinim me udhëheqësin e njesisë në mënyrë periodike, nevojat për trajnim të nëpunësve civil të institucionit për aftësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve për zhvillimit profesional;
 - 2.5. menaxhon proceset e ndërlidhura me emërimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, transferimit, suspendimit, pensionimit dhe çdo proces tjetër që ndërlidhet me punësimin e zyrtarëve publik;
 - 2.6. mbështet procedurën për vlerësimin e performancës, rekomandon transferimin e nëpunësit civil, si dhe menaxhon paraqitjen në punë të zyrtarit publik;
 - 2.7. administron planet dhe dosjet individuale përmes SIMBNj-së;
 - 2.8. administrimi i pagave sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.9. kryen çdo detyrë tjetër të dhënë me ligj.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është pesë (5) nëpunës civil.

Neni 30
Divizioni për Komunikim me Publikun

1. Misioni i Divizionit të Komunikimit Publik është të komunikojë në mënyrë efektive informacionin me publikun, palët e interesuara dhe audiencat e tjera relevante, duke nxitur mirëkuptimin, besimin dhe angazhimin me Agjencinë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Komunikim me Publikun, janë:
 - 2.1. ofrimi i informatave për opinionin dhe mediat për veprimtarinë e Agjencisë;
 - 2.2. pasqyrimi i punës dhe aktiviteteve të Agjencisë tek institucionet vendore e ndërkombëtare;

- 2.3. grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i informacioneve lidhur me punën dhe aktivitetet e Agjencisë;
 - 2.4. mbikëqyrja dhe redaktimi i faqes zyrtare të Agjencisë;
 - 2.5. koordinimi i përgatitjes së materialeve dhe broshurave për botim dhe shpërndarje tek publiku për veprimtarinë e Agjencisë;
 - 2.6. bashkëpunimi me mediat për organizimin e konferencave për mediat dhe intervistave, si dhe ofrimi i informatave dhe hartimi i përmbledhjeve nga paraqitja e mediave; dhe
 - 2.7. dhënia e deklaratave, njoftimeve, raporteve dhe publikimeve të tjera për opinionin publik;
 - 2.8. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Komunikim me Publikun raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Komunikim Publik është tre (3) nëpunës civil.

Neni 31 **Divizioni për Buxhet dhe Financa**

1. Misioni i Divizionit të Buxhetit dhe Financave është të ofrojë udhëheqje financiare, planifikim dhe mbikëqyrje për të siguruar përdorim të përgjegjshëm dhe efikas të fondeve publike, duke mbështetur qëllimet e përgjithshme të Agjencisë.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Buxhet dhe Financa, janë:
 - 2.1. planifikimi i buxhetit të Agjencisë;
 - 2.2. krijimi i programeve dhe nën-programeve në bazë të kërkesave të departamenteve të Agjencisë;
 - 2.3. përgatitja e analizave buxhetore, si dhe raporteve mbi shpenzimin e buxhetit;
 - 2.4. planifikimi i buxhetit në përputhje me objektivat e Agjencisë;
 - 2.5. përgatitja e raporteve periodike lidhur me realizimin e buxhetit;
 - 2.6. realizimi i shpenzimeve të buxhetit në harmoni me planet e Agjencisë;
 - 2.7. përgatitja e analizave financiare, si dhe shpenzimi i buxhetit;
 - 2.8. përgatitja e raporteve të ndryshimeve periodike dhe vjetore;

- 2.9. ofrimi i të dhënave për auditorët e brendshëm dhe të jashtëm në kryerjen e auditimeve;
- 2.10. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Buxhet dhe Financa është tetë (8) nëpunës civil.

Neni 32 **Divizioni i Prokurimit**

1. Misioni i Divizioni të Prokurimit është të sigurojë në mënyrë efikase dhe efektive mallrat dhe shërbimet e nevojshme, duke siguruar vlerën më të mirë, pajtueshmërinë dhe praktikat etike gjatë gjithë procesit.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Prokurimit, janë:
 - 2.1. përgatitja, koordinimi dhe zbatimi i planit vjetor të Agjencisë në fushën e prokurimit publik;
 - 2.2. sigurimi që mallrat, shërbimet dhe punët blihen në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive;
 - 2.3. këshillimi i njësisve kërkuese, për metoda dhe praktika përkatëse të prokurimit;
 - 2.4. organizimi dhe menaxhimi i aktiviteteve të prokurimit. Përcaktimi i metodologjisë së prokurimit për tenderë dhe procedura të vlerësimit të çmimeve;
 - 2.5. pranimi/refuzimi i rekomandimeve të propozuara. Nënshkrimi i kontratave pas rikonfirmimit që informatat financiare nuk kanë ndryshuar substancialisht;
 - 2.6. ofrimi i mbështetjes së menaxhmentit në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
 - 2.7. përcjellja e dështimeve të kontraktuesve të cilët kanë dështuar të përmbushin obligimet e tyre kontraktuese kurdo që informohet nga Menaxheri i Projektit në lidhje me kompensimet e duhura, likuidimin e dëmeve dhe aranzhimin e anulimit të kontratave;
 - 2.8. hartimi i raportit vjetor në fund të secilit vit fiskal për kontratat e nënshkruara;
 - 2.9. kryen çdo detyrë tjetër sipas legjislacionit në fuqi.
3. Udhëheqësi i Divizionit të Prokurimit raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë.
4. Numri i të punësuarve në Divizionin e Prokurimit është tre (3) nëpunës civil.

Neni 33
Njësitë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit

1. Njësitë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit janë të organizuara si njësi të shërbimit publik në kuadër të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.
2. Njësitë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit janë të organizuara në tridhjetepesë (35) komuna të Republikës së Kosovës.
3. Themelimi i Njësive Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit, organizimi i brendshëm, mënyra e funksionimit, si dhe numri i të punësuarve, rregullohen me akt të veçantë në përputhje me Ligjin përkatës për Zjarrëfikje dhe Shpëtim.

Neni 34
Njësitë e Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë

1. Njësitë e Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë janë të organizuara si njësi të shërbimit publik në kuadër të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë janë të përcaktuara në Ligjin përkatës për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.
3. Organizimi i brendshëm, mënyra e funksionimit, si dhe numri i të punësuarve, rregullohen me akt të veçantë në përputhje me Ligjin përkatës për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

KREU II
DISPOZITAT KALIMTARE DHE
PËRFUNDIMTARE

Neni 35
Dispozitat përfundimtare

1. Shërbimet e auditimit kryhen nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin për zyrtarët publik brenda institucionit është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.
3. Rritja apo zvogëlimi i numrit të personelit në pajtim me Ligjin Vjetor të Buxhetit nuk krijon nevojë për plotësim-ndryshimin e kësaj Rregulloreje, përveç në rastet kur krijohen dhe/apo shfuqizohen strukturat organizative.
4. Pjesë e kësaj Rregulloreje është Shtojca Struktura Organizative e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

Neni 36
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 03/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

26 janar 2026

Organogrami i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME)

Pozicioni/Struktura	Klasa	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri
1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv në AME			Totali: 6
Drejtori Ekzekutiv	Drejtues i lart		1
Zëvendësdrejtori Ekzekutiv	Drejtues i lart		2
Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar i Lartë Certifikues	Profesional 1	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar Administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2. Departamenti i Parandalimit			Totali: 11
Drejtori i Departamentit të Parandalimit	Drejtues i mesëm		1
2.1. Divizioni i Vlerësimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë			Totali: 3
Udhëheqësi i Divizionit të Vlerësimit të Rreziqeve	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Identifikimin dhe Vlerësimin e Rreziqeve	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Vlerësimin e Rreziqeve	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
2.2. Divizioni i Zvogëlimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë			Totali:4
Udhëheqësi i Divizionit të Zvogëlimit të Rreziqeve nga Fatkeqësitë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Analizën e Rrezikut	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	3
2.3. Divizioni i Përpunimit të të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri			Totali: 3
Udhëheqës për Përpunimin e të Dhënave për Zjarre dhe Vetëdijesim Publik për Rreziqet nga Zjarri	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Grumbullim dhe Përpunim të të Dhënave	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
3. Departamenti i Gatishmërisë			Totali: 32
Drejtori i Departamentit të Gatishmërisë	Drejtues i mesëm		1
3.1. Divizioni për Planifikim dhe Koordinim të Gatishmërisë Emergjente			Totali: 4
Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim dhe Koordinim të	Drejtues i ulët		1

Gatishmërisë Emergjente			
Zyrtar i Lartë për Analiza dhe Planifikim	Profesional 1	Grupi i sigurisë	2
Zyrtar i Lartë për Koordinim të Shërbimeve Emergjente	Profesional 1	Grupi i sigurisë	1
3.2. Divizioni për Programe dhe Standarde të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit			Totali: 3
Udhëheqësi i Divizionit për Programe dhe Standarde të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Standardizim të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Organizim dhe Zhvillim të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
3.3. Qendra e Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit			Totali: 21
Udhëheqësi i Qendrës së Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Standardizim, Trajnime dhe Licencim	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Trajnim	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	15
Zyrtar Administrativ	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
Nëpunës/e Teknik/e dhe Mbështetës			2
3.4. Qendra e Ushtrimeve të Integruara			Totali: 3
Udhëheqësi i Qendrës së Ushtrimeve të Integruara	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Kurrikula	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar për Programin e Ushtrimeve dhe Vlerësimin e Gatishmërisë	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
4. Departamenti i Operacioneve			Totali: 87
Drejtor i Departamentit të Operacioneve	Drejtues i mesëm		1
4.1. Divizioni për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes			Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Operacioneve të Reagimit dhe Rimëkëmbjes	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Emergjenca	Profesional 1	Grupi i sigurisë	2
4.2. Qendra Operative e Agjencisë			Totali: 3
Udhëheqës i Qendrës së AME-së	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë i Qendrës Operative Emergjente	Profesional 1	Grupi i sigurisë	1

Zyrtar i Ndërlidhjes në Qendrën Operative Emergjente	Profesional 2	Grupi i sigurisë	1
4.3. Qendra Operative Emergjente 112 - Prishtinë			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Prishtinë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.4. Qendra Operative Emergjente 112 - Mitrovicë			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Mitrovicë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.5. Qendra Operative Emergjente 112 – Mitrovicë e Veriut			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Mitrovicë e veriut	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.6. Qendra Operative Emergjente 112 - Pejë			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Pejë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.7. Qendra Operative Emergjente 112 – Prizren			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Prizren	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.8. Qendra Operative Emergjente 112 – Gjiilan			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Gjiilan	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.9. Qendra Operative Emergjente 112 – Ferizaj			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Ferizaj	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
4.10 Qendra Operative Emergjente 112 – Gjakovë			Totali: 10
Udhëheqësi i QOE 112 Gjakovë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar për Emergjencë	Profesional 2	Grupi i sigurisë	9
5. Departamenti i Inspektimit			Totali: 48
Drejtor i Departamentit të Inspektimit	Drejtues i mesëm	Grupi i sigurisë	1
5.1. Divizioni i Masave të Mbrojtjes nga Zjarri			39
Udhëheqës i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Zjarri	Drejtues i ulët		1
Inspektor për Parandalimin nga Zjarri	Profesional 1	Grupi i sigurisë	38
5.2. Divizioni i Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera			Totali: 8

Udhëheqës i Divizionit të Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Drejtues i ulët		1
Inspektor i Masave të Mbrojtjes nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	Profesional 1	Grupi i sigurisë	7
6. Departamenti i Shërbime të Përgjithshme			Totali: 18
Drejtor i Departamentit të Shërbimeve të Përgjithshme	Drejtues i mesëm		1
6.1. Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime			Totali: 9
Udhëheqës i Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Logjistikë	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar i Lartë për Furnizim dhe Transport	Profesional 1	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Transport	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Administrimin e Automjeteve	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Mallra dhe Shërbime	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar për Pranim të Mallit	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	1
Zyrtar për Logjistikë	Profesional 2	Grupi i administrimit të përgjithshëm	2
6.2. Divizioni për Administrimin e Dokumenteve			Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Administrimin e Dokumenteve	Drejtues i ulët	Grupi i arkiv- dokumentacionit	1
Zyrtar i Lartë për Arkiv	Profesional 1	Grupi i arkiv- dokumentacionit	1
Zyrtar për Administrimin e Dokumenteve	Profesional 2	Grupi i arkiv- dokumentacionit	1
6.3. Divizioni Teknologjisë Informative			Totali: 5
Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Komunikime Elektronike dhe TI	Profesional 1	Grupi i teknologjisë së të dhënave	1
Zyrtar i Lartë i TI-së për Sisteme	Profesional 1	Grupi i teknologjisë informative	1
Zyrtar i Lartë për GIS	Profesional 1	Grupi i hartografisë dhe GIS	1
Zyrtar i TI-së për Përkrahje	Profesional 2	Grupi i teknologjisë informative	1

7. Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare			Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim me Organizata Ndërkombëtare	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
Zyrtar i Lartë për Koordinim me IPA	Profesional 1	Grupi i shkencave shoqërore	1
8. Divizioni Ligjorë			Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit Ligjorë	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë Ligjor	Profesional 1	Grupi ligjor	1
Zyrtar Ligjor	Profesional 2	Grupi ligjor	1
9. Divizioni i Burimeve Njerëzore			Totali: 5
Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore	Profesional 1	Grupi i burimeve njerëzore	1
Zyrtar i Lartë për Burime Njerëzore dhe Paga	Profesional 1	Grupi i burimeve njerëzore	1
Zyrtar për Burime Njerëzore	Profesional 2	Grupi i burimeve njerëzore	1
Zyrtar për Burime Njerëzore dhe Paga	Profesional 2	Grupi i burimeve njerëzore	1
10.Divizioni për Komunikim me Publikun			Totali: 3
Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun	Profesional 1	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
Zyrtar për Informim	Profesional 2	Grupi i marrëdhënieve me publikun dhe informimin	1
11.Divizioni për Buxhet dhe Financa			Totali: 8
Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	Profesional 1	Grupi i buxhetit dhe financave	3
Zyrtar për Buxhet dhe Financa	Profesional 2	Grupi i buxhetit dhe financave	1
Zyrtar për Buxhet, Financa dhe Projekte Ndërkombëtare	Profesional 2	Grupi i ekonomisë	1
Zyrtar i Lartë i Pasurisë	Profesional 1	Grupi i ekonomisë	1
12.Divizioni i Prokurimit			Totali: 3

Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit	Drejtues i ulët		1
Zyrtar i Lartë për Prokurim	Profesional 1	Grupi i prokurimit publik	1
Zyrtar për Prokurim	Profesional 2	Grupi i prokurimit publik	1

Numri i përgjithshëm i punonjësve:	297
---	------------

Vëmendje: Në këtë organogram janë të përfshirë edhe numri aktual i 4 njësive të zjarrëfikjes dhe shpëtimit në katër komuna veriore, si rezultat i integritit sipas Marrëveshjes së Brukselit. Numri i pjesëtarëve në këto njësi është 70 pjesëtarë.

ORGANOGRAMI I AME

